



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 101/2 Prot

Tiranë, më 04/3/2021

VENDIM

Nr. 15, datë 04. 3.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 101 Prot., datë 14.01.2021, (saktësuar me e-mail-in datë 15.01.2021), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit nëpërmjet kërkesës së datës 28.12.2020, depozituar në adresën elektronike Fludian.Cuka@turizmi.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

- *Kopje të plotë të korrespondencës (komunikimeve shkresore), nëpërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkisë Elbasan, në periudhën 1 shtator 2013 – 1 dhjetor 2014.*

Në mungesë të një përgjigje nga ana Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit".

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 101/1 prot., datë 20.01.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit, brenda datës 26.01.2021.

Në tejkallim të afatit të përcaktuar, Autoriteti Publik me e-mail-in datë 01.02.2021, ka kthyer përgjigje duke informuar ndër të tjera se: "...z. i është kërkuar sqarimi i kërkesës për informacion dhe orientimi specifik në lidhje me kërkesën e parashtruar. Duke qenë se nga ana e kërkuarit nuk është kthyer një përgjigje apo saktësuar kërkesa, nuk është vijuar me kthimin e përgjigjes".

Ankuesi, me e-mail-in datë 18.02.2021, ka vijuar ankimin duke kërkuar përmbushjen e kërkesës për dhënie të informacionit.

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në të cilin parashikohet se: "*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", bazuar dhe në nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore.

Duke patur parasysh situatën e krijuar si pasojë e përhapjes së COVID-19 dhe në zbatim të masave të marra nga institucionet përkatëse, seanca dëgjimore u zhvillua nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik (on-line/vidio-call), në datën 23.02.2021, ora 11.30, me prezencën e palëve.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër. Gjithashtu, në vijim, ankuesi për lehtësi të kthimit të përgjigjes kërkoi t'i jepej mundësia për t'u paraqitur pranë Autoritetit Publik dhe të konsultonte librin e protokollit, ose t'i vendosej në dispozicion një listë e korrespondencës midis dy autoriteteve publike, në mënyrë që ai të saktësonte kërkimin e tij.

Në përfundim të seancës dëgjimore, përsa u parashtrua nga ankuesi, u dakortësua nga koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik (në vijim "Koordinatori"), i cili kërkoi kohë për të vepruar brenda datës 25.02.2021.

Në vijim, Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 25.02.2021, ka kthyer përgjigje duke argumentuar ndër të tjera se: *"...Gjatë seancës dëgjimore, z. Rama parashtron dy nënkërkesa që janë vazhdimi i të parës dhe konkretisht: 1- Të vijë personalisht në protokollin e ministrisë dhe të kërkojë dokumentacionin ai vetë; 2- Ti dërgojmë në një listë me sugjerime për dokumentat e mundshme të komunikimeve dhe ai të zgjedhë çfarë informacioni i nevojitet nga këto sugjerime që do i japim ne. Pra, ai kërkon që institucioni ti listojë z. Rama në formë sugjerimi titujt e mundshëm të shkresave të shkëmbyera midis Ministrisë dhe Bashkisë Elbasan, dhe ai të zgjedhë se çfarë i nevojitet nga kjo listë. Për pikën 1. në protokollin e ministrisë ka edhe dokumenta konfidenciale dhe Z. nuk mund të ketë akses në gjithë protokollin e institucionit, në lidhje me pikën 2, ne nuk mund t'i sugjerojmë z. çfarë mund të kërkojë ai nga ne".*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumenti i parashtruar në përgjigjen e Autoritetit Publik nuk qëndron.

Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar në parim, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit *"informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*". Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e disponuar.

Në shkronjën a, të pikës 2 të nenit 10 të ligjit të sipërcituar, parashikohet gjithashtu se: *"Koordinatori për të drejtën e informimit i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij".*

Lidhur me argumentin e parashtruar nga Koordinatori, se: *"...në protokollin e ministrisë ka edhe dokumenta konfidenciale"*, Komisioneri vlerëson se, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, Autoriteti Publik duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim"*.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur

ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 101 Prot., datë 14.01.2021 të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 28.12.2020, brenda datës 11 . 3 .2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 04 . 3 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

